

# DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



## 1-VJETORI I DHOMËS SË BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE VJEN NDRYSHE!

Me rastin e 1-vjetorit të krijimit të Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare, më datë 18.11.2020 u mbajt ceremonia festive me mbi 120 të ftuar nga Shqipëria dhe Diaspora që e ndoqën ceremoninë online. Ndryshe nga sa do të ishte festuar një ngjarje kaq e madhe në kushte normale, për shkak të situatës COVID-19, ky 1-vjetor erdhi ndryshe. Aktiviteti u hap me fjalën e kryetarit të Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare z. Ardian Lekaj, i cili falenderoi gjithë pjesmarrësit, megjithëse në rrethana jo nga më normalet, u bashkuan për të kremtuar këtë përvjetor të parë për Dhomën e Biznesit të Diasporës Shqiptare. Në fjalën e tij përshendetëse z. Lekaj surprizoi me dorëzimin e çmimit “Vizioni i Diasporës” drejtuar Ministrit të Shtetit për Diasporën z. Pandeli Majko.

**PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI:** >>>>



## GREQI/ BIZNESET SHQIPTARE NË ISHULLIN E KRETËS

Në ishullin e Kretës jetojnë aktualisht rreth 30.000 qytetarë shqiptarë, të vendosur aty prej më shumë se dy dekadash. Ka një numër të konsiderueshëm shqiptarësh që janë me biznese në fusha të ndryshme. Ndër vite, pjesa më e madhe janë integruar në mënyrë impresionuese dhe mjaft prej tyre janë pronarë biznesesh jetike për ekonominë e ishullit, por edhe për vetë komunitetin, teksa në këto biznese janë punësuar përgjithësisht bashkatdhetarë të pronarëve, pra shqiptarë.

**PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI:** >>>>



## PANDEMIA “ORIENTON” SHQIPËRINË DREJT GJERMANISË – INSTAT: RRIJTJA MË E MADHE E EKSPORTEVE DHE IMPORTEVE

Periudha e pandemisë duket të ketë shërbyer për të forcuar marrëdhëniet tregtare me Gjermaninë. Sipas raportit më të fundit të Instat mbi tregtinë e jashtme, rritja më e madhe e eksporteve në këtë 10 muaj ka qenë me Gjermaninë, konkretisht me 14.3%. E në fakt, e njëjta gjë vlen edhe për importet, ku Gjermania është sërish shteti me rritjen më të madhe. Sipas Instat, importet me Gjermaninë në janar – tetor 2020 janë rritur me 0.8%, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2019-ës.

**PËR MË SHUMË INFORMACION KLIKONI:** >>>>



## JAVA NË LAJME

“LIDHU, KRIJO, BASHKËPUNO”, DIASPORA FLET ONLINE



SUEDI/ COVID-19, MASA SHITESË PËR KOMPANITË DHE PUNONJËSIT



SHBA/ DY SHQIPTARË MES 100 PERSONALITETEVE MË TË FUQISHËM NË STATEN ISLAND



## KURSI I KËMBIMIT

MONEDHA	BLERJE	SHITJE
USD	104.40	105.10
EUR	123.50	124.10
CHF	113. <sup>80</sup>	114.90
GBP	137.40	138.50
DKK	16. <sup>25</sup>	16.65